



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 17 paragrafi 1 pika b) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 24 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-025 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.50/2009) për mbrojtjen e mjedisit, nenit 8 paragrafi 1 pika d) dhe nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 30.08.2024, merr këtë:

### VENDIM NR.42/2024/KG

## PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS (PLVM) PËR PERIUdhËN 2024-2029

#### Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM) për periudhën 2024-2029.

#### Neni 2

Bartës i projektit të hartimit të planit do të jetë Shoqata "Rrjeti për aktivizëm qytetar" (*Mreža za građanski aktivizam*), duke u bazuar në Thirrjen publike nr.1854/24 të datës 15.04.2024 dhe Marrëveshjen për ndarjen e mjeteve financiare nr.2721/24 të datës 05.06.2024, në bashkëpunim me drejtoritë kompetente komunale.

#### Neni 3

Qëllimi i hartimit të Planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM) për periudhën 2024-2029 është identifikimi i sfidave kryesore mjedisore dhe propozimi i masave për zgjidhjen e tyre.

#### Neni 4

Pas hartimit të Planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM) për periudhën 2024-2029, dokumenti do t'i dorëzohet Kuvendit të Komunës së Graçanicës për shqyrtim dhe miratim.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimit janë përgjegjës drejtoritë komunale.

#### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Milan Dimitrijević**